



Albanian-American
Development Foundation
www.aadf.org



www.cleanscore.al

THIRRJE PËR APLIKIME - KONKURS ME PUNIME KËRKIMORE

AADF nëpërmjet projektit CleanScore, ka mundësuar për universitetet publike partnere qasjen në librarinë digjitale JSTOR – www.jstor.org. Duke qenë një nga libraritë digjitale më të mëdha në botë, JSTOR u mundëson studentëve, stafit pedagogjik dhe hulumtuesve të fushave të ndryshme materiale në disiplinat dhe fushat e tyre të interesit.

CleanScore për të nxitur kërkimin shkencor cilësor, si dhe përdorimin e librarisë digjitale JSTOR, ka ndërmarrë iniciativën për të zhvilluar “Konkursin Kombëtar të Punimeve Kërkimore”. Pjesëmarrja në këtë konkurs është e hapur vetëm për studentët që ndjekin aktualisht një program studimi në një nga universitetet partnere të CleanScore:

- Universiteti i Tiranës
- Universiteti i Mjekësisë, Tiranë
- Universiteti Bujqësor i Tiranës
- Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- Universiteti “Fan. S. Noli”, Korçë
- Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
- Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan
- Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër
- UET - Universiteti European i Tiranës
- Kolegji Luarasi
- Universiteti Mesdhetar i Tiranës

Në përfundim të konkursit do të shpallen fituesit dhe çmimet përkatëse:



Data të rëndësishme:

26 Prill – 10 Qershor	Afati i dorëzimit të punimeve
11 – 25 Qershor	Seleksionimi dhe vlerësimi i punimeve
30 Qershor	Shpallja e fituesve

Fushat kryesore ku duhet të bazohen punimet kërkimore:

1. Arsimit dhe Liderit
2. Sipërmarrje dhe Ekonomi
3. Turizëm Kulturor dhe Eko-turizëm


Për orientim në lidhje me tematika ku mund të bazoheni klikoni **KËTU**



www.jstor.org



www.akademia.al





KRITERET E APLIKIMIT & FORMATI I PUNIMIT

1. Kriteret e pranimit të punimeve:

- Punimi duhet t'i përmbahet rregullave të shkrimit akademik
- Punimi nuk duhet të përmbajë plagjiaturë, e cila do të kontrollohet nëpërmjet platformës **Akademia.al**
- Punimi kërkimor duhet të jetë argumentues
- Punimi duhet të përmbajë 2.500 – 3.000 fjalë
- Të paktën 50% e referencave në punim duhet të jenë nga JSTOR
- Punimi duhet të jetë në gjuhën shqipe

2. Kërkesa teknike për formatit:

- Faqosja (Layout): Format i faqes: A4
- Shkrimi (Font): Times New Roman
- Hapësira e tekstit (Spacing): Double spaced
- Madhësia e shkrimit (Font size): 12 pt
- Hapësira e faqes (Margins): 2.5 cm në të katër drejtimet e faqes

3. Kapaku (faqja e parë) duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

- Të dhënat e universitetit logo, universiteti, fakulteti, departamenti
- Të dhënat e studentit emër, mbiemër, viti i studimit, drejtimi i studimeve
- Fusha e punimit & tema e punimit

Shkarkoni shembujt e gatshëm **KËTU** ose **KËTU**

4. Zhvillimi & Përmbajtja

Punimi duhet të jetë i ndarë në: hyrje, zhvillim, përfundime dhe rekomandime. Çdo paragraf duhet të ketë të paktën një referencë. Çdo faqe duhet të ketë jo më pak se tre referenca dhe mënyra e referimit duhet të jetë e njëjtë për të gjithë punimin.

5. Bibliografia

Bibliografia duhet të jetë në një faqe më vete në fund të punimit dhe nuk është pjesë e numrit total të fjalëve. Format i bibliografisë duhet të jetë i njëjtë me mënyrën e formatit të referimit gjatë punimit.

Shkarkojeni materialin orientues të bibliografisë **KËTU**

Dorëzimi i punimit:

Punimet do të dërgohen në adresën e mëposhtme të email-it. Në konkurs do të pranohen vetëm ato punime të dorëzuara gjatë afatit të shpallur dhe nga studentë aktiv të universiteteve partnere të CleanScore.

JSTOR@CleanScore.al

